



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 57

Datë 24 prill 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 31/2014 datë 3.4.2014	Për sigurimin shëndetësor të veçantë të punonjësve të strukturave speciale operacionale të Policisë së Shtetit	2161
Ligj nr. 32/2014 datë 3.4.2014	Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar	2161
Ligj nr. 34/2014 datë 3.4.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të investimit në sektorin e ujit	2162
Ligj nr. 35/2014 datë 3.4.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për mbrojtjen shoqërore	2170
Ligj nr. 41/2014 datë 17.4.2014	Për një shtesë në ligjin nr. 8668, datë 23.11.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar	2180
Dekret nr. 8546 datë 21.4.2014	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit	2180
Vendim i Kuvendit nr. 19/2014, datë 10.4.2014	Për mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, të ndryshuar	2180
Vendim i Kuvendit nr. 20/2014, datë 10.4.2014	Për zgjedhjen e zotit Ermir Kapedani komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit	2180

Vendim i Kuvendit nr. 21/2014, datë 10.4.2014	Për zgjedhjen e zotit Arben Shkëmbi komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit	2181
Vendim i Kuvendit nr. 22/2014, datë 10.4.2014	Për zgjedhjen e zonjës Etilda Gjonaj (Saliu) komisionere në Institucionin e Avokatit të Popullit	2181

LIGJ
Nr. 31/2014

**PËR SIGURIMIN SHËNDETËSOR TË VEÇANTË
TË PUNONJËSVE TË STRUKTURAVE SPECIALE
OPERACIONALE TË POLICISË SË SHETITIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Punonjësit e strukturave speciale operacionale të Policisë së Shtetit, në funksion të përmbushjes së detyrës së tyre, përfitojnë sigurim shëndetësor të veçantë, për shërbime shëndetësore, të cilat nuk janë pjesë e paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Neni 2

Sigurimi i shëndetit për punonjësit e strukturave speciale operacionale të Policisë së Shtetit bëhet sipas kontratës së lidhur me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Ky sigurim mbulon shpenzimet për kontrollin parandalues, diagnostikues dhe kurues, të ofruara nga institucionet shëndetësore, brenda dhe jashtë vendit.

Efekti financiar i këtij ligji mbulohet nga Buxheti i Shtetit.

Neni 3

Kategoria e punonjësve të strukturave speciale operacionale të Policisë së Shtetit që kanë të drejtë të bëjnë sigurimin e veçantë të shëndetit, sipas këtij ligji, lista e shërbimeve shëndetësore, si dhe autoriteti mjekësor që vendos për shërbimet shëndetësore, rast pas rasti, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 3.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8542, datë 21.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 32/2014

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8438, DATË
28.12.1998, "PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT",
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 24, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Në rastin e bankave, degëve të bankave të huaja dhe subjekteve financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarisë së kredihënies, në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, fshirja e borxhit të keq, lidhur me procesin e kredihënies, njihet si shpenzim i zbritshëm me plotësimin e këtyre afateve:

a) 365 ditë pas depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit të ekzekutimit të detyrueshëm të përmbaruesi, në rast se kredia është e siguruar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme;

b) 365 ditë pas lëshimit nga gjykata të urdhrimit të ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e garantuar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 3.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8543, datë 21.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 34/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM (IBRD) PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT TË INVESTIMIT NË SEKTORIN E
UJIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit të investimit në sektorin e ujit, nëpërmjet një huaje prej 62 500 000 (gjashtëdhjetë e dy milionë e pesëqind mijë) eurosh.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8544, datë 21.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

TEKSTI PËRFUNDIMTAR I NEGOCIUAR

Dhjetor 11.12.2013

Emri i juristëve:

Nightingale Rukuba-Ngaiza/Aimona Tashieva

HUA NUMËR _____-AL

MARRËVESHJE HUAJE

(Projekti i investimit në sektorin e ujit)

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM**

Datë _____, 2014

Marrëveshje e datës _____, 2014 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ("Huamarrësi") dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka"). Huamarrësi dhe Banka bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Kushtet e Përgjithshme; përkufizimet

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç përkruhet dhe në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) janë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveçse nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale, të përdorura në këtë Marrëveshje, kanë kuptimin e përshkruar në Kushtet e Përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, në një vlerë prej gjashtëdhjetë e dy milionë e pesëqind mijë euro (€62,500,000) ("Huaja"), shumë, e cila mund të konvertohet herë pas here në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të kësaj Marrëveshjeje ("Huaja") për të ndihmuar për financimin e Projektit të përshkruar në pasqyrën 1 të kësaj Marrëveshjeje ("Projekti").

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas në përputhje me seksionin IV të pasqyrës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa Fillestare që do të paguhet nga Huamarrësi do të jetë sa një e katërta e një përqindëshit ose 0.25% e Shumës së Huas.

2.04 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo periudhë do të jetë në një normë të barabartë me normën e referencës për Monedhën e Huas plus Marzhin Fiks; me kusht që pas një konvertimi të të gjithave ose ndonjë pjesë të shumës së principalit të huas, interesi i pagueshëm nga Huamarrësi gjatë periudhës së konvertimit mbi këtë shumë do të përcaktohet në përputhje me dispozitat përkatëse të nenit IV të Kushteve të Përgjithshme. Pavarësisht nga sa më lart, nëse ndonjë shumë e Vlerës së Tërhequr të Huas mbetet e papaguar për një periudhë prej tridhjetë ditësh, atëherë Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi do të llogaritet siç parashikohet në seksionin 3.02(e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.05 Datat e pagesës janë 15 prilli dhe 15 tetori të çdo viti.

2.06 Principali i Huas do të shlyhet në përputhje me Pasqyrën e Amortizimit të parashtruar në pasqyrën 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 a) Huamarrësi mund të kërkojë në çdo kohë ndonjë prej konvertimeve të mëposhtme në termat e Huas, me qëllim lehtësimin e menaxhimit të matur të borxhit: i) një konvertim të Monedhës së Huas për të gjithë vlerën apo për një pjesë të saj, të tërhequr apo të patërhequr, në një Monedhë të Aprovuar; dhe ii) një konvertim të normës bazë të interesit, të zbatueshme për

të gjithë apo një pjesë të principalit të huas së tërhequr dhe të pashlyer, nga një Kurs i Ndryshueshëm në një Kurs Fiks ose anasjellas, ose nga një Kurs i Ndryshueshëm i bazuar në një Marzh të Ndryshueshëm, te një Kurs i Ndryshueshëm i bazuar në një Marzh Fiks.

b) Çdo konvertim i kërkuar në përputhje me paragrafin (a) të këtij seksioni, i cili është i pranueshëm nga Banka, do të konsiderohet një "Konvertim", siç përcaktohet në Kushtet e Përgjithshme dhe do të zbatohet në përputhje me dispozitat e nenit IV të Kushteve të Përgjithshme, si dhe të Udhëzuesit të Konvertimeve.

Neni 3 Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të realizojë Projektin nëpërmjet MTI-së, në përputhje me dispozitat e nenit V të Kushteve të Përgjithshme.

3.02 Pa kufizime ndaj dispozitave të seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe përveç rasteve kur Huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, Huamarrësi do të sigurojë që Projekti të kryhet në përputhje me dispozitat e pasqyrës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4 Hyrja në fuqi; përfundimi

4.01 Kushti Shtesë i Hyrjes në Fuqi përbëhet si më poshtë, në faktin se Huamarrësi ka përgatitur dhe miratuar Manualin e Operimit të Projektit në mënyrë të kënaqshme për Bankën.

4.02 Afati i Hyrjes në Fuqi është 120 ditë (njëqind e njëzet ditë) pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5 Përfaqësuesit; adresat

5.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i tij i Financave.

5.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3

Tirana, Albania

Faks: 355 42228494

5.03 Adresa e Bankës është:

International Bank for Reconstruction and Development
1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Adresa kabllore:Teleks:Faks:

INTBAFRAD248423(MCI) ose1-202-477-6391

Washington, D.C.64145(MCI)

Rënë dakord më _____, _____, siç është përshkruar në ditën dhe vitin e shkruar më lart.

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: _____

Përfaqësuesi i autorizuar _____

Emri: _____

Titulli: _____

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Përfaqësuesi i autorizuar _____

Emri: _____

Titulli: _____

PASQYRA 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivat e Projektit janë: i) përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, të zonës që mbulon Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizime Durrës (NUKD); dhe ii) përmirësimi i performancës financiare të NUK, Durrës.

Projekti konsiston në komponentët e mëposhtëm:

Komponenti I: Investimet prioritare të furnizimit me ujë

Kryerja e investimeve prioritare të furnizimit me ujë, duke përfshirë ndër të tjera:

a) Zhvillimin e puseve të prodhimitarisë së furnizimit me ujë dhe linja e re e transmetimit për të trajtuar mungesën e ujit në zonën e shërbimit të NUK Durrës;

b) Zhvillimin e rezervuarëve të ngritur, të cilët do të lidhin njësitë e qeverisjes vendore me zonën e shërbimit të NUK - Durrës dhe përgjatë linjës ekzistuese të tubacionit të transmetimit të sistemit të furnizimit me ujë, në mënyrë të qëndrueshme; dhe

c) Rehabilitimin dhe përmirësimin e rrjetit ekzistues të shpërndarjes në zonën e shërbimit të NUKD-së, si dhe sigurimin e pajisjeve për zbulimin e rrjedhjeve, si dhe valvulat e reduktimit të presionit, për të zvogëluar humbjet e ujit në rrjet, të gjitha këto nëpërmjet furnizimit me mallra, punime, shërbime konsulence dhe shërbime jokonsulence.

Komponenti II: Investimet në rrjetin e kanalizimeve

Kryerja e Investimeve prioritare në rrjet do të ndihmojë në zgjerimin e kapacitetit të rrjetit ekzistues të kanalizimeve, duke përfshirë ndër të tjera:

a) Punime përmirësimi në zonat kritike të rrjetit të kanalizimeve dhe ujërave të shiut, duke mbledhur dhe trajtuar të gjitha ujërat e bardha të shiut, si dhe për të reduktuar vërshimin e ujërave;

b) Ndërtimin e rrjetit dytësor dhe tretësor të kanalizimeve për zonën bregdetare në Durrës;

c) Sigurimin e pajisjeve për pastrim të thellë të kanalizimeve; dhe

d) Forcimin e aftësisë fillestare të NUKD-it për operimin dhe mirëmbajtjen e Impiantit të ri të Pastrimit të Ujërave të zeza në Durrës; të gjitha këto nëpërmjet mallrave, punimeve shërbime të konsulencës, trajnimeve dhe shërbimeve të jokonsulencës.

Komponenti III: Programi i Zhvillimit Institucional, forcimi i NUKD-së dhe menaxhimi i kërkesës për ujë

Mbështetja e politikave të Huamarrësit në sektorin e ujit, në nivel vendor dhe kombëtar, duke përfshirë ndër të tjera:

a) Hartimin dhe zbatimin e një Programi Monitorimi të Kërkesës për Ujë, nëpërmjet zbatimit të një sistemi efikas matjeje në zonën e shërbimit të NUKD-së, si dhe kryerjen e një fushate sensibilizuese të fokusuar në ruajtjen e ujit dhe përmirësimin e menaxhimit të tij;

b) Rritjen e kapaciteteve të Njësisë së Monitorimit të Performancës dhe Standardeve Referuese në MTI nëpërmjet aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve për të përmirësuar funksionet e monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave;

c) Përgatitjen dhe vënien në zbatim të një planibiznesi dhe një plani për rritje të performancës nëpërmjet forcimit institucional, operacional, tregtar, si dhe kapaciteteve menaxheriale të NUKD-së, përfshirë edhe planifikimin e sondazheve rishikuese me klientët dhe kryerjen e fushatave të ndërgjegjësimit publik;

d) Rritjen e kapaciteteve operuese të stafit të NUKD-së nëpërmjet trajnimeve dhe kryerjen e një studimi të fokusuar në kursimin e energjisë, si dhe hartimin e një plani paraprak menaxhimi mbi kursimin e energjisë; dhe

e) Kryerjen e një auditit vjetor të pavarur të NUKD-së; të gjitha këto me anë të furnizimit me mallra, punime, shërbime konsulence dhe shërbime jokonsulencë.

Komponenti IV: Mbështetje për zbatimin e Projektit

Mbështetja e funksionit monitorues, vlerësues dhe raportues të MTI-së, rishikime teknike të investimeve të Projektit, mbikëqyrje e Projektit nëpërmjet financimit të shpenzimeve operative, sigurimi i mallrave, i shërbimeve të konsulencës dhe i shërbimeve të jokonsulencës.

PASQYRA 2

ZBATIMI I PROJEKTIT

SEKSIONI I

MARRËVESHJET E ZBATIMIT

A. Angazhimet institucionale

Huamarrësi do të zbatojë Projektin nëpërmjet MTI-së, dhe gjatë gjithë kohës së zbatimit të tij, Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së, duhet të sigurohet që PIU në MTI është duke u mbështetur me fonde të mjaftueshme, objekte, shërbime dhe burime të tjera, si dhe me staf të kualifikuar dhe të mjaftueshëm në numër.

B. Manuali i operimit të Projektit

1. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së, duhet të sigurohet që gjatë gjithë ecurisë së tij, Projektit do të zbatohet në përputhje me Manualin e Operimit të Projektit.

2. Përveç rasteve kur Huamarrësi dhe Banka do të bien dakord me shkrim, Huamarrësi nuk do të ndryshojë apo të heqë dorë, ose të lejojë që të ndryshojë apo të hiqet dorë nga ndonjë dispozitë e Manualit të Operimit të Projektit.

C. Komiteti i Projektit

1. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së, duhet jo më vonë se data 30 prill 2014, të krijojë një Komitet të Projektit me përbërje, terma reference dhe burime të kënaqshme për Bankën.

2. Komiteti i Projektit do të jetë përgjegjës për komunikimin e nevojshëm dhe koordinimin ndërmjet palëve të interesuara të Projektit.

D. Marrëveshja plotësuese

1. Pa kufizime ndaj dispozitave të seksionit I.A të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi mund të hyjë në një Marrëveshje Plotësuese me NUKD-në, me qëllim shlyerjen e pagesave nga NUKD ndaj Huamarrësit në kuadër të Huas, sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën.

2. Në rastin e një marrëveshjeje të tillë, Huamarrësi do të ushtrojë të drejtat e tij sipas Marrëveshjes Plotësuese, në mënyrë që të mbrojë interesat e veta dhe të Bankës, si dhe për të përmbushur qëllimet e Projektit. Huamarrësi nuk do të nënshkruajë, ndryshojë, anashkalojë apo të heqë dorë nga Marrëveshja Plotësuese ose ndonjë dispozitë e saj, pa marrë aprovimin paraprak me shkrim të Bankës.

E. Marrëveshja e zbatimit të Projektit

1. Pa kufizime ndaj dispozitave të seksionit I.A të kësaj Marrëveshjeje, dhe duke përjashtuar rastet kur Banka dhe Huamarrësi bien dakord ndryshe dhe jo më vonë se data 30 prill 2014, Huamarrësi do të mundësojë që MTI-ja të hyjë në një Marrëveshje të Zbatimit të Projektit (më poshtë e quajtur MZP) me NUKD-në, në terma dhe kushte të pranueshme nga Banka, të cilat duhet të përfshijnë ndër të tjera: angazhimin e NUKD-së në: i) objektivat e Projektit; ii) të ofrojë ndihmën teknike për Projektin, në rastet kur kërkohet; iii) të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm për kryerjen e auditit vjetor të pavarur të financiar nga komponenti III (e) të Projektit; dhe iv) të lehtësojë përgatitjen e planit të përmirësimit të performancës, të financuara sipas pjesës III (c) të Projektit dhe kryerjen e rekomandimeve të këtij plani.

2. Huamarrësi duhet të sigurohet që MTI-ja do të ushtrojë të gjithë të drejtat e saj sipas MZP-së, në mënyrë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe të Bankës, si dhe në zbatim të objektivave të Projektit. Huamarrësi duhet të sigurohet që MTI-ja nuk do të

nënshkruajë, ndryshojë, shfuqizojë apo të heqë dorë nga Marrëveshja e Zbatimit të Projektit apo ndonjë dispozitë e saj, pa marrë aprovimin paraprak me shkrim të Bankës.

F. Antikorrupsioni

Huamarrësi duhet të sigurohet që Projektin realizohet në përputhje me dispozitat e udhëzimeve për antikorrupsionin.

G. Masat mbrojtëse

1. Huamarrësi do të sigurojë që të gjitha aktivitetet e ndërmarra me qëllim të realizimit të Projektit, do të jenë në përputhje me Politikën Mbrojtëse të Bankës.

2. Huamarrësi do të sigurojë, nëpërmjet MTI-së, zbatimit e RPF, RAP(s), VNM dhe PMM, të gjitha në përputhje me termat e tyre përkatës, duke përfshirë aplikimin dhe zbatimin, sipas rastit, të politikave, të procedurave dhe të marrëveshjeve përkatësisht të parashtruara.

3. Huamarrësi do të sigurojë që MTI-ja nuk do të ndryshojë, pezullojë, shfuqizojë, përfundojë apo heqë dorë ose nuk do të lejojë ndryshimin, pezullimin, shfuqizimin, përfundimin apo heqjen dorë nga asnjë prej PF, RAP(s), VNM dhe PMM, ose ndonjë dispozite të tyre, përveç se me aprovimin paraprak me shkrim të Bankës.

4. Huamarrësi do ta realizojë Projektin në përputhje me specifikat vendore të RAP dhe nuk do të ndryshojë, pezullojë, shfuqizojë, përfundojë apo heqë dorë nga asnjë dispozitë e planit të mësipërm, pa marrë aprovimin paraprak me shkrim të Bankës. Në veçanti, Huamarrësi do të sigurojë që:

a) Të gjitha veprimet e nevojshme janë ndërmarrë për të minimizuar, për aq sa është e mundur, çdo humbje të pavullnetshme nga ana e personave të prekur, asetëve produktive apo lejimit në pasuri produktive ose të ardhurave ose mjeteve të jetesës, përkohësisht ose përgjithmonë;

b) Të gjitha të drejtat mbi tokën, uzufruktet ose të drejtat zakonore dhe prona të tjera caktohen dhe sigurohen ndërsa paguhet kompensimi i tyre i barabartë dhe shlyerja kryhet në përputhje me parimet dhe procedurat institucionale të përcaktuara në RAP-in përkatës;

c) Personat e prekur do të kompensohen në mënyrë të barabartë, duke i rivendosur dhe rehabilituar në përputhje me RAP-in;

d) Zbatimi i marrëveshjeve për risistemimin, duke përfshirë kompensimin, rivendosjen apo rehabilitimin e personave të prekur, janë të dokumentuara; dhe

e) Zbatimi, monitorimi, vlerësimi i RAP-it përkatës është përfunduar dhe raportuar në një mënyrë të pranueshme për Bankën;

f) Huamarrësi nuk do të fillojë asnjë punim në kuadër të Projektit, derisa RAP-i përkatës të jetë zbatuar plotësisht.

SEKSIONI II

RAPORTIMI I MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT TË PROJEKTIT

A. Raportet e Projektit

Huamarrësi, përmes MTI-së, do të monitorojë dhe do të vlerësojë progresin e Projektit dhe do të përgatisë raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve të pranueshëm për Bankën. Çdo Raport Projektit do të mbulojë periudhën e një semestri kalendarik dhe do t'i dërgohet Bankës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

B. Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe auditimet

1. Huamarrësi, përmes MTI-së, do të mbajë ose do të kërkojë që të mbahet një sistem menaxhimi financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 të Kushteve të Përgjithshme.

2. Pa kufizim të dispozitave të pjesës A të këtij seksioni, Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së, do të përgatisë dhe do t'i paraqesë Bankës, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, raporte të përkohshme financiare të paaudituar për Projektin, të cilat mbulojnë tremujorin, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën.

3. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së, do të marrë masa për auditimin e Pasqyrave Financiare që lidhen me Projektin, në pajtim me dispozitat e seksionit 5.09 (b) të Kushteve të Përgjithshme. Çdo auditim i Pasqyrave Financiare do të mbulojë periudhën e një viti fiskal të Huamarrësit. Pasqyrat Financiare të Audituar për secilën periudhë të tillë do t'i paraqiten Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

SEKSIONI III

PROKURIMI

A. Të përgjithshme

1. Mallrat, Punimet dhe Shërbimet e tjera të Jokonsulencës. Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e tjera të jokonsulencës të kërkuara për Projektin dhe që janë të financuara nga fondet e Huas do të prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në seksionin I të Udhëzimeve të Prokurimit, si dhe në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e Konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga fondet e Huas, do të prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në seksionet I dhe IV të Udhëzimeve të Konsulentëve dhe me dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizimet. Termat me germa kapitale të përdorura më poshtë në këtë seksion për të përshkruar

metoda të caktuara prokurimi ose metoda të rishikuara nga Banka të kontratave të veçanta i referohen metodës korresponduese të përshkruar në seksionet II dhe III të Udhëzimeve të Prokurimit, apo seksionet II, III, IV dhe V të Udhëzimeve për Konsulentët, sipas rastit.

B. Metodatat e caktuara të Prokurimit të Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve të tjera të Jokonsulencës

1. Tender i Hapur Ndërkombëtar. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat, punimet dhe shërbimet e tjera të jokonsulencës do të prokurohen sipas kontratave të fituara mbi bazën e Tenderit të Hapur Ndërkombëtar.

2. Metoda të tjera për Prokurimin e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve të tjera të Jokonsulencës. Metodatat e mëposhtme, përveç Tenderit të Hapur Ndërkombëtar, mund të përdoren për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të tjera të jokonsulencës për ato kontrata të përcaktuara në Planin e Prokurimit: a) Tenderi i Hapur Kombëtar, në bazë të dispozitave shtesë të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij seksioni; b) Blerje; dhe c) Prokurim i Drejtpërdrejtë.

3. Ndryshime të Procedurave të Huamarrësit për Tenderin e Hapur Kombëtar. Procedurat për Tenderin e Hapur Kombëtar (THK) bazohen në Procedurat e Tenderimit të Hapur, siç përcaktohet në ligjin e prokurimit publik (LPP) të Shqipërisë (ligji nr. 9643, datë 20 nëntor 2006, i ndryshuar), megjithatë, me kusht që një procedurë e tillë t'i nënshtrohet dispozitave të seksionit I dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të Udhëzimeve të Prokurimit dhe dispozitave të mëposhtme shtesë:

i) Procedurat e "Tenderit të Hapur", të përcaktuara në LPP të Shqipërisë, do të zbatohen për të gjitha kontratat e financuara nga Banka;

ii) Ofertuesit e huaj nuk do të përjashtohen nga tenderi dhe asnjë preferencë e asnjë lloji nuk do t'u jepet ofertuesve kombëtare në procesin e tenderimit. Ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri do të lejohen të konkurrojnë vetëm nëse janë ligjërish dhe financiarisht të pavarura dhe operojnë sipas ligjit tregtar të Huamarrësit. Regjistrimi nuk do të përdoret për të vlerësuar kualifikimet e ofertuesve;

iii) Ofertat do të hapen në një vend publik, menjëherë pas afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, në prani të përfaqësuesve, të cilët zgjedhin të marrin pjesë;

iv) Entet prokurorese do të përdorin modelin e dokumenteve të tenderit që është miratuar nga Banka;

v) Në rast të ofertimit të çmimeve më të larta, në krahasim me vlerësimin zyrtar, të gjitha ofertat nuk do të refuzohen pa pëlqimin paraprak të Bankës;

vi) Procedura e një zarfi të vetëm do të përdoret për dorëzimin e ofertave;

vii) Postkualifikimi do të kryhet vetëm për ofertuesit me ofertën më të ulët; asnjë ofertë nuk do të refuzohet në kohën e hapjes së ofertave për arsye kualifikimi;

viii) Ofertuesit në formën e një ndërmarrjeje të përbashkët do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe individualisht;

ix) Përpara refuzimit të të gjitha ofertave dhe lajmërimit për oferta të reja, duhet të merret aprovimi paraprak i Bankës;

x) Kontratat do t'i jepen ofertuesit me ofertën më të ulët të pranueshme, i cili është përcaktuar të jetë i kualifikuar për të operuar në përputhje me kriteret e vlerësimit, të paracaktuara dhe të publikuara paraprakisht;

xi) Pas hapjes së ofertave nuk do të lejohen bisedime me ofertuesin me ofertën më të ulët ose me ndonjë ofertues tjetër;

xii) Kontratat me kohëzgjatje të madhe (më shumë se 18 muaj) përmbajnë dispozita të përshtatshme për rregullimin e çmimeve;

xiii) Garancitë e Ofertës dhe Kontratës duhet të jetë në formatin e përfshirë në dokumentet e tenderit. Garancia e ofertës do të jetë e vlefshme për njëzet e tetë ditë (28) pas periudhës fillestare të vlefshmërisë së ofertës ose pas çdo periudhe zgjatjeje nëse kërkohet. Asnjë parapagim nuk do të bëhet pa një garanci të përshtatshme të pagesës së paradhënies;

xiv) Dokumentet e tenderit dhe kontrata që konsiderohen të pranueshme nga Banka, duhet të përfshijnë dispozita që deklarojnë politikën e Bankës për sanksionimin e firmave apo individëve, të cilët janë përfshirë në mashtrim dhe korrupsion, siç përcaktohet në Udhëzimet e Prokurimit;

xv) Në përputhje me Udhëzimet e Prokurimit, çdo dokument tenderi dhe kontrate, që financohet nga të ardhurat e Huas, do të sigurojë që ofertuesit, furnizuesit dhe kontraktorët dhe nënkontraktorët e tyre, agjentët, personeli, këshilltarët, ofruesit e shërbimeve ose furnizuesit do të lejojnë Bankën të inspektojë të gjitha llogaritë, të dhënat dhe dokumentet e tjera që lidhen me dorëzimin e ofertave dhe përmbushjen e kontratës, dhe t'i ketë të audituara nga auditë të emëruar nga Banka. Veprimet që synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e inspektimit të Bankës dhe të drejtat e auditimit, të parashikuara në Udhëzimet e Prokurimit, përbëjnë një praktikë penguese, siç përcaktohet në Udhëzimet e Prokurimit.

C. Metodatat e Caktuara të Prokurimit të Shërbimeve të Konsulentëve

1. Përzgjedhja e bazuar në Cilësi dhe Kosto. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen sipas kontratave të fituara, të dhëna mbi bazën e Përzgjedhjes së bazuar në Cilësi dhe Kosto.

2. Metoda të tjera për Prokurimin e Shërbimeve të Konsulentëve. Metodatat e mëposhtme, përveç përzgjedhjes

së bazuar në Cilësi dhe Kosto, mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato kontrata të cilat janë të përcaktuara në Planin e Prokurimit: a) Përzgjedhja e bazuar në Cilësi; b) Përzgjedhja sipas një buxheti fiks; c) Përzgjedhja me kosto më të ulët; d) Përzgjedhja e bazuar në Kualifikimet e Konsulentëve; d) Përzgjedhja e firmave konsulente si burim i vetëm; dhe f) Procedurat e Përzgjedhjes së Konsulentëve Individualë si burim i vetëm.

D. Rishikimi nga Banka i Vendimeve të Prokurimit

Plani i prokurimit do të përcaktojë kontratat të cilat do t'i nënshtrohen Rishikimit Paraprak të Bankës. Të gjitha kontratat e tjera do t'i nënshtrohen Rishikimit pasues nga Banka.

SEKSIONI IV

TËRHEQJA E SHUMAVE TË HUAS

A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas në përputhje me dispozitat e nenit II të Kushteve të Përgjithshme, këtij seksioni, si dhe udhëzimeve shtesë që Banka do të përcaktojë duke njoftuar Huamarrësin (përfshirë “Udhëzimet e Bankës Botërore për Disbursimet e Projektit” të muajit maj 2006, siç rishikohet herë pas here nga Banka dhe siç bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje në bazë të këtyre udhëzimeve) për të financuar Shpenzimet e Pranueshme që përcaktohen në tabelën në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e Shpenzimeve të Pranueshme që mund të financohen nga të ardhurat e Huas (“Kategoria”), alokimin e shumave të Kredisë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për Shpenzime të Pranueshme në secilën kategori.

Kategoria	Shuma e Huas së Alokuar (shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
1. Punime	53,900,000	100%
2. Mallra, shërbime jokonsulente	3,700,000	100%
3. Shërbime konsulente dhe trajnime	4,500,000	100%
4. Kostot operative	243,750	100%
5. Tarifa fillestare	156,250	Shuma e pagueshme në pajtim me nenin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07 (b) të Kushteve të Përgjithshme
SHUMA TOTALE	62,500,000	

B. Kushtet e Tërheqjes; Periudha e Tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesat e kryera para datës së kësaj Marrëveshjeje, përveç kur

tërheqjet deri në një shumë totale që nuk kalon ekuivalentin e 6,000,000 € mund të bëhen për pagesat e kryera para kësaj date, por në ose pas datës 31 maj 2013 për Shpenzime të Pranueshme.

2. Data e mbylljes është 30 qershor 2019.

PASQYRA 3

PASQYRA E AMORTIZIMIT

1. Tabela e mëposhtme përcakton Datat e Pagesave të Principalit të Huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të huas, të pagueshme në çdo Datë Pagesë të Principalit (“Kësti në Përqindje”). Nëse shumat e Huas janë tërhequr plotësisht deri në datën e pagesës së parë të principalit, shuma e principalit të Huas së shlyer nga Huamarrësi në çdo Datë Pagesë të Principalit do të përcaktohet nga Banka, duke shumëzuar: a) Balancën e Tërhequr të Kredisë që është në Datën e Parë të Pagesës së Principalit; me b) Këstin në Përqindje për çdo Datë Pagesë të Principalit, ndërsa kjo shumë e shlyeshme duhet të përshtatet, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë të referuar në paragrafin 4 të kësaj shtojce në të cilën zbatohet Konvertimi i Valutës

Data e pagesës së principalit	Kësti në përqindje (shprehur si përqindje)
Në çdo 15 prill dhe 15 tetor Duke filluar nga data 15 prill 2024 deri 15 prill 2036	3.85%
Më 15 tetor 2036	3.75%

2. Nëse shumat e Huas nuk janë tërhequr plotësisht duke filluar nga data e pagesës së parë të principalit, shuma e principalit të Huas së shlyeshme nga Huamarrësi në çdo Datë Pagesë të Principalit, do të përcaktohet si më poshtë:

a) Në masën që çdo e ardhur e Huas është tërhequr që nga data e pagesës së parë të principalit, Huamarrësi do të shlyejë Balancën e Tërhequr të Huas që nga ajo datë në përputhje me paragrafin 1 të kësaj shtojce;

b) Çdo shumë e tërhequr pas Datës së Pagesës së parë të Principalit do të shlyhet në secilën Datë të Pagesës së Principalit, që bie pas datës së tërheqjes në shumën e përcaktuar nga Banka, duke shumëzuar shumën e çdo tërheqjeje të tillë me një koeficient, numëruesi i të cilit është Përqindja e Këstit fillestar, specifikuar në tabelën në paragrafin 1 të kësaj shtojce për datën e lartpërmendur të Pagesës së Principalit (“Kësti Fillestar në Përqindje”) dhe emëruesi i të cilit është shuma e të gjitha Kësteve Fillestare në Përqindje të mbetura për Datat e Pagesës së Principalit që bien në ose pas kësaj date, ndërsa këto shuma të shlyeshme duhet të përshtatet, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë të referuar në paragrafin 4 të kësaj shtojce, në të cilën zbatohet Konvertimi i Valutës.

3. a) Shumat e Huas së tërhequr brenda dy muajve kalendarikë para çdo Date Pageze të Principalit duhet, vetëm për qëllime të llogaritjes së shumave të principalit të pagueshme në çdo Datë të Pagesës së Principalit, duhet të trajtohen si të tërhequra dhe të papaguara në Datën e Pagesës së dytë të Principalit pas datës së tërheqjes dhe do të shlyhen në çdo Datë Pageze të Principalit, duke filluar me Datën e dytë të Pagesës së Principalit pas datës së tërheqjes.

b) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi, nëse në çdo kohë Banka miraton një sistem të faturimit të datave të detyrueshme të pagesave sipas të cilit faturat janë lëshuar në ose pas Datës së Pagesës Përkatëse të Principalit, dispozitat e një nënparagrafi të tillë nuk do të zbatohen më për çdo tërheqje të bërë pas miratimit të një sistemi të tillë faturimi.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të kësaj shtojce, pas një Konvertimi Valute të të gjithë ose ndonjë pjese të Balancës së Tërhequr të Kredisë në një Monedhë të Miratuar, shuma e konvertuar në Monedhën e Aprovuar, që është e shlyeshme në çdo Datë Pageze të Principalit që ndodh gjatë Periudhës së Konvertimit, do të përcaktohet nga Banka duke shumëzuar këtë shumë në monedhën e saj të emërimit menjëherë para konvertimit ose me: i) kursin e këmbimit që pasqyron shumat e principalit në Monedhën e Aprovuar të pagueshme nga Banka nën Transaksionin e Mbrojtur të Monedhës në lidhje me Konvertimin; ose ii) nëse Banka e përcakton këtë në përputhje me Udhëzimet e Konvertimit, komponenti i kursit të këmbimit i Normës së Projektuar.

5. Nëse Balanca e Tërhequr e Huas emërtohet në më shumë se një Monedhë të Huas, dispozitat e kësaj Pasqyre do të zbatohen veçmas për shumën e emërtuar në secilën Monedhë të Huas, në mënyrë që të përgatisin një pasqyrë të veçantë amortizimi për çdo shumë të tillë.

SHTOJCA SEKSIONI I PËRKUFIZIME

1. “Udhëzimet antikorrupsion” nënkupton “Udhëzimet mbi Parandalimin dhe Luftën kundër Mashtrimit dhe Korrupsionit në Projektet e Financuara nga kreditë e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-s”, të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në janar 2011.

2. “Kategori” nënkupton një kategori të përcaktuar në tabelën në seksionin IV të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3. “Udhëzimet për Konsulentin” nënkupton “Udhëzimet: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve për Huat e IBRD-së dhe Granteve dhe Kredive të IDA-s prej Huamarrësve të Bankës Botërore”, të muajit janar 2011.

4. “UKD” nënkupton Shoqërinë Ujësllës-Kanalizime Durrës të Huamarrësit dhe shoqërinë

aksionare publike me personalitet juridik, që është themeluar dhe vepron në përputhje me vendimin e Gjykatës së Rrethit Durrës nr. 51, të datës 15 mars 1993, ose çfarëdo pasardhësi ligjor të saj.

5. “Zona e Shërbimit të UKD-së” nënkupton zonën e përcaktuar si të tillë dhe të caktuar për qëllime të operacioneve të UKD-së, në përputhje me vendimin nr. 660 të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, datë 12 shtator 2007.

6. “VNM” nënkupton Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të muajit maj 2013, të përgatitur dhe të miratuar nga Huamarrësi, të publikuar në territorin e Huamarrësit më 21 maj 2013 dhe në Infoshop të Bankës në datën 22 maj 2013, të përmendur në shtojcën 2, seksioni I.A të kësaj Marrëveshjeje dhe të pranueshme për Bankën, duke përkrahur rregullat, udhëzimet dhe procedurat për të vlerësuar ndikimet mjedisore të aktiviteteve të Projektit dhe përcaktimin e masave për të ulur, zbutur apo kompensuar ndikimet negative mjedisore dhe rritjen e ndikimeve pozitive të aktiviteteve të Projektit, ndërsa do të ndryshohen herë pas here me aprovimin paraprak të Bankës.

7. “PMM” nënkupton një Plan Menaxhimi Mjedisor të Caktuar të përbërë nga plani i zbutjes mjedisore dhe Plani i Monitorimit Mjedisor i muajit maj 2013, i përgatitur dhe i miratuar nga Huamarrësi në pajtim me VNM-në dhe në përputhje me dispozitat e Manualit të Operacioneve të Projektit, i cili duhet të zbatohet nga Huamarrësi në përputhje me dispozitat e shtojcës 2, neni I.G.2 i kësaj Marrëveshjeje, të pranueshme për Bankën, ku janë përcaktuar hollësitë specifike të masave për të menaxhuar rreziqet mjedisore të identifikuar apo potenciale dhe për të zbutur, për të zvogëluar dhe/ose për të kompensuar ndikimet negative mjedisore që lidhen me zbatimin e aktiviteteve në kuadër të Projektit, së bashku me një bazë mjedisore dhe sociale për çdo vendpunim, detaje të kuadrit përkatës mjedisor legjislativ, të mjaftueshëm institucional, masat monitoruese dhe raportuese për të garantuar zbatimin e duhur të tyre, dhe informacionet e rregullta në përputhje me kushtet e saj, ndërsa mund të ndryshohen dhe plotësohen herë pas here me aprovimin paraprak me shkrim të Bankës.

8. “Kushtet e Përgjithshme” nënkupton “Kushtet e Përgjithshme për Hua të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim”, të datës 12 mars 2012.

9. “Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës” ose “MTI” nënkupton ministrinë përgjegjëse të Huamarrësit, ndër të tjera, për ujësllësit dhe kanalizimet ose pasardhësin ligjor të Huamarrësit.

“Shpenzimet Operative” nënkupton Kostot Operative rritëse të kryera nga NJZP-ja për llogari të zbatimit, menaxhimit, monitorimit dhe mbikëqyrjes (si shpenzime të tilla të përcaktuara në buxhetin vjetor të NJZP-së) së

Projektit, duke përfshirë pajisje zyre, mirëmbajtje të pajisjeve të zyrës, tarifa të licencimit të programeve/përdoruesve, komunikimin, udhëtime lokale, operimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe pagat e stafit të NJZP-së (por duke përjashtuar pagat e nëpunësve civilë të Huamarrësit).

10. “Plani i Përmirësimit të Performancës” nënkupton një plan të përgatitur nga Huamarrësi që përshkruan, ndër të tjera, veprime specifike për forcimin e kompensimit të kostos, reduktimin e humbjeve të ujit dhe përmirësimin e efikasitetit të përgjithshëm të operacioneve të UKD-së.

11. “NJZP” nënkupton Njësinë e Zbatimit të Projektit të krijuar brenda MTI-së dhe të përmendur në seksionin I.A të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

12. “NJMPs” nënkupton Njësinë e Monitorimit, Performancës dhe Standardizimit, përgjegjëse për monitorimin e Projektit, dhe aktualisht që vepron në kuadër të MTI-së ose pasardhësit ligjor të saj.

13. “Komiteti i Projektit” nënkupton një komitet që do të krijohet nga Huamarrësi në pajtim me seksionin I.C të Programit 2 të kësaj Marrëveshjeje, me terma reference dhe përbërje të pranueshme për Bankën, dhe i përbërë nga përfaqësuesit e MTI-së, UKD-së dhe njësitë e qeverisjes vendore, sipas rastit.

14. “Udhëzimet e Prokurimit” nënkupton “Udhëzimet: Prokurimi i Mallrave, i Punimeve dhe i Shërbimeve të tjera të Jokonsulencës sipas Huave të IBRD-së dhe Kredive dhe Granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, të muajit janar 2011.

15. “Marrëveshja e Zbatimit të Projektit” nënkupton një marrëveshje që do të lidhet nga MTI-ja dhe UKD-ja për qëllimet e Projektit, në terma dhe kushte të pranueshme për Bankën Botërore, në pajtim me paragrafin 5 të seksionit I.A të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

16. “Manuali i Operacioneve të Projektit” nënkupton manualin e veprimeve të Projektit të përgatitur në përputhje me seksionin I.B të pasqyrës 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe të konfirmuar si të pranueshëm nga ana e Bankës dhe të miratuar nga Huamarrësi, duke përshkruar dhe përcaktuar procedurat për zbatimin e Projektit dhe masat institucionale, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe duke përfshirë, ndër të tjera, oraret e veprimeve të kërkuara për t’u kryer sipas Projektit, rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e Projektit (duke përfshirë UKD-në dhe Komitetin e Projektit), stafin, aspektet e mirëbesimit, procedurat teknike dhe operacionale për zbatimin e Projektit, duke përfshirë edhe procedurat e menaxhimit financiar (buxhetimin, kontabilizimin dhe kontrollin e brendshëm, disbursimin dhe qarkullimin e fondeve, raportimin financiar, raportet vjetore,

procedurat dhe masat e auditiveve të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë grafikun e llogarive specifike të Projektit), procedurat e prokurimit, masat e monitorimit dhe vlerësimit dhe masat e tjera të mirëbesimit dhe administrative, si dhe termat e nevojshëm të referencës që mund të ndryshohen herë pas here në marrëveshje me Bankën.

17. “Plani i Prokurimit” nënkupton Planin e Prokurimit të Huamarrësit për Projektin, të datës 11 nëntor 2013, dhe të përmendur në paragrafin 1.18 të Udhëzimeve të Prokurimit dhe paragrafin 1.25 të Udhëzimeve të Konsulentëve dhe do të përditësohet herë pas here në përputhje me paragrafët e lartpërmendur.

18. “Planet e Veprimit për Zhvendosje” ose “PVZH” nënkupton dokumentet specifike të vendpunimit, të përgatitura dhe të miratuara nga Huamarrësi, në pajtim me KPZH-në dhe në përputhje me Manualin e Operacioneve dhe pasqyrën 2, pjesa I (G) e kësaj Marrëveshjeje, dhe të pranueshme për Bankën, i cili përmban, ndër të tjera, një program të veprimeve, masave dhe politikave për kompensimin e personave, duke përfshirë marrëveshjet e kompensimit, buxhetit dhe vlerësimet e kostos, dhe burimet e financimit, së bashku me marrëveshjet institucionale të mjaftueshme, masa monitorimi dhe raportimi për të garantuar zbatimin e duhur dhe informacionet e rregullta në përputhje me kushtet e tij për çdo vendpunim që mund të ndryshohet dhe plotësohet herë pas here me aprovimin paraprak me shkrim të Bankës; dhe “PVZH” nënkupton një prej referencave të mësipërme të PVZH-së.

19. “Kuari i Politikave të Zhvendosjes” ose “KPZH” nënkupton kuadrin e politikave të Huamarrësit për Zhvendosje të muajit maj, 2013, të publikuara në territorin e Huamarrësit më 21 maj 2013 dhe në Infoshop të Bankës, më 21 maj 2013, të përmendur në shtojcën 2, seksioni I (G) të kësaj Marrëveshjeje, dhe të pranueshme për Bankën Botërore, duke garantuar procedura dhe udhëzime për përgatitjen, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve të Veprimit për Zhvendosje, ndërsa Kuadri i lartpërmendur mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak të Bankës.

20. “Marrëveshja Plotësuese” nënkupton një marrëveshje që Huamarrësi mund ta lidhë me UKD-në për qëllimet e shlyerjes së të ardhurave të Huas nga UKD-ja, në termat dhe kushtet e pranueshme për Bankën.

21. “Trajnimet” nënkupton të gjitha shpenzimet që lidhen me aktivitetet e trajnimit në kuadër të Projektit, si mbledhje pune trajnuese, seminare, vizita studimore dhe trajnime lokale, shpenzimet e udhëtimit dhe shumat e dietave për trajnerët dhe të trajnuarit, koston e materialeve të trajnimit, qiratë e hapësirave dhe të

pajisjeve, dhe shpenzime të tjera përkatëse të miratuara nga Banka.

“Politikat Mbrojtëse të Bankës Botërore” nënkupton politikat operacionale dhe procedurat e Bankës të përcaktuara në Manualin Operacional të Bankës sipas OPS / BPS 4.01,4.04,4.36,4.09, 4.11, 4.10, 4.12, 4.37, 7.50 dhe 7.60, manuali cili është botuar në www.WorldBank.org/opmanual.

LIGJ
Nr. 35/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
MBRETËRISË SË BELGJIKËS
PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për mbrojtjen shoqërore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 3.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8545, datë 21.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

SHTOJCA 2

MARRËVESHJE
PËR MBROJTJEN SHOQËRORE
NDËRMJET MBRETËRISË SË BELGJIKËS DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Mbretëria e Belgjikës dhe Republika e Shqipërisë, me dëshirën për të ndërtuar marrëdhënie të ndërsjella ndërmjet dy vendeve në fushën e sigurimeve shoqërore, vendosën të lidhin një Marrëveshje për këtë qëllim dhe ranë dakord për sa më poshtë:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje:

a) Termi “Belgjikë” nënkupton Mbretërinë e Belgjikës; Termi “Shqipëri” nënkupton Republikën e Shqipërisë.

b) Termi “territor” nënkupton:

Në lidhje me Belgjikën, territorin e Mbretërisë së Belgjikës;

Në lidhje me Shqipërinë, territorin e Republikës së Shqipërisë.

c) Termi “legjislacion” nënkupton ligjet dhe rregulloret për sigurimet shoqërore, të specifikuar në nenin 2.

d) Termi “autoritet kompetent” nënkupton ministrat, secili në masën që është përgjegjës në lidhje me zbatimin e legjislacionit të specifikuar në nenin 2.

e) Termi “agjenci” nënkupton institucionin, organizatën apo autoritetin me përgjegjësi të plotë apo të pjesshme për zbatimin e legjislacionit të specifikuar në paragrafin 1 të nenit 2.

f) Termi “agjenci kompetente” nënkupton agjencinë që përgjigjet financiarisht për përfitimet.

g) Termi “periudhë sigurimi” nënkupton:

sa i përket Belgjikës, çdo periudhë të njohur si të tillë në legjislacionin belg, sipas të cilit kjo periudhë është plotësuar, si dhe çdo periudhë të njohur si ekuivalente me një periudhë sigurimi sipas këtij legjislacioni;

sa i përket Shqipërisë, çdo periudhë kontributi, periudhë punësimi, aktivitet profesional dhe çdo periudhë e njohur si ekuivalente me një periudhë sigurimi sipas legjislacionit shqiptar.

h) Termi “përfitim” nënkupton çdo pension, çdo përfitim në natyrë apo në para, të parashikuar nga legjislacioni i secilit prej shteteve kontraktuese, përfshirë çdo shtesë apo rritje të aplikueshme sipas legjislacionit të specifikuar në nenin 2.

i) Termi “anëtar i familjes” nënkupton çdo person të përkufizuar apo të njohur si anëtar i familjes apo të përcaktuar si anëtar i familjes nga legjislacioni në bazë të të cilit jepen përfitimet apo në rastin e referuar në nenin 14, nga legjislacioni i shtetit kontraktues, në territorin e të cilit ka vendqëndrimin ky person.

j) Termi “vendqëndrim” nënkupton vendin ku një person ka vendqëndrimin e zakonshëm.

k) Termi “qëndrim” nënkupton vendqëndrimin e përkohshëm.

2. Çdo term që nuk është parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni ka kuptimin e përcaktuar për të në legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 2

Fushëveprimi ligjor

1. Kjo Marrëveshje zbatohet:

a) në lidhje me Belgjikën, në legjislacionin për:

i) përfitimet për sëmundje të përkohshme dhe barrëlindje, në natyrë apo në para, për personat e punësuar, marinarët e marinës tregtare dhe personat e vetëpunësuar;

ii) përfitimet për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale;

iii) pensionet e pleqërisë dhe pensionet familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar;

iv) përfitimet e invaliditetit për personat e punësuar, marinarët e marinës tregtare dhe personat e vetëpunësuar;

dhe në lidhje vetëm me pjesën II, në legjislacionin për:

v) sigurimet shoqërore për personat e punësuar;

vi) statutin social të personave të vetëpunësuar;

b) në lidhje me Shqipërinë, në të gjithë legjislacionin për:

i) sa i përket skemës së sigurimeve shoqërore:

- përfitimet në para për sëmundje për personat e punësuar;

- përfitimet në para për barrë lindje për personat e punësuar dhe personat e vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

- përfitimet në para për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale për personat e punësuar;

- pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

ii) sa i përket skemës së detyrueshme të sigurimit shëndetësor, përfitojnë nga skema e detyrueshme e sigurimit shëndetësor kategoritë e mëposhtme:

a) personat e punësuar;

b) individët e vetëpunësuar;

c) punëtorët e papaguar të familjes;

d) personat e tjerë ekonomikisht aktivë;

e) personat që marrin përfitime nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

f) personat që marrin asistencë sociale apo pagesa për invaliditet sipas legjislacionit përkatës;

g) personat e regjistruar si punëkërkuar të papunë në Shërbimin Kombëtar të Punësimit;

h) azilkërkuarët e huaj në Republikën e Shqipërisë;

i) fëmijët nën moshën 18 vjeç;

j) nxënësit dhe studentët nën moshën 25 vjeç, nëse nuk kanë të ardhura nga aktivitete ekonomike;

k) kategoritë e individëve të përcaktuara nga ligje të veçanta;

l) personat e siguruar vullnetarisht.

2. Kjo Marrëveshje zbatohet, gjithashtu, për të gjitha aktet apo rregulloret që amendojnë apo shtrijnë legjislacionin e specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Kjo zbatohet për çdo akt apo rregullore që shtrin skemat ekzistuese në kategori të reja përfituesish, nëse, lidhur me këtë, shteti kontraktues që ka amenduar legjislacionin e vet, nuk njofton brenda gjashtë muajve nga botimi zyrtar i ligjeve në fjalë, shtetin tjetër kontraktues për kundërshtimet e veta.

Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për aktet apo rregulloret që parashikojnë krijimin e një dege të re të

sigurimeve shoqërore, nëse autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese nuk bien dakord për këtë aplikim.

Neni 3

Fushëveprimi personal

Nëse nuk specifikohet ndryshe, kjo Marrëveshje do të zbatohet për të gjithë personat që janë apo kanë qenë subjekt i legjislacionit të secilit prej shteteve kontraktuese dhe për persona të tjerë që trashëgojnë të drejta nga këta persona.

Neni 4

Trajtimi i barabartë

Nëse nuk specifikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, personat e referuar në nenin 3, do të jenë subjekt i detyrimeve dhe do të përfitojnë nga legjislacioni i shtetit kontraktues me të njëjtat kushte, si dhe shtetasit e atij shteti.

Neni 5

Eksportimi i përfitimeve

1. Nëse nuk specifikohet ndryshe, në këtë Marrëveshje, përfitimet në para për sëmundje, invaliditet, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale, si dhe pensionet e pleqërisë dhe pensionet familjare, të përfituara sipas legjislacionit të secilit prej shteteve kontraktuese, nuk mund të jenë subjekt reduktimi apo ndryshimi për shkak të faktit se përfituesi qëndron apo ka vendqëndrimin në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

2. Përfitimet në para, për pleqëri, në rast të humbjes së mbajtësit të familjes, të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, që jepen nga secili prej shteteve kontraktuese, u paguhen shtetasve të shtetit tjetër kontraktues me qëndrim në territorin e një shteti të tretë, sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin kombëtar të shtetit të mëparshëm kontraktues për shtetasit e vet me qëndrim në territorin e atij shteti të tretë.

Neni 6

Dispozitat për reduktimin apo pezullimin

Në rast se një përfitim përkon me përfitime të tjera të sigurimeve sociale apo me të ardhura të tjera nga një aktivitet profesional, dispozitat për reduktimin apo pezullimin, të parashikuara në legjislacionin e një shteti kontraktues, do të zbatohen për përfituesit edhe nëse këto përfitime përfitoheshin nga një skemë e shtetit tjetër kontraktues, apo nëse aktivitetet profesionale përkatëse ushtrohen në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

Megjithatë, kjo dispozitë nuk zbatohet kur përfitime të së njëjtës natyrë jepen nga agjenci kompetente të të dy shteteve kontraktuese në përputhje me dispozitat e neneve 29 dhe 30 të kësaj Marrëveshjeje.

PJESA II
DISPOZITA PËR LEGJISLACIONIN E
ZBATUESHËM

Neni 7

Dispozita të përgjithshme

1. Në bazë të neneve 8 deri 10, legjislacioni i zbatueshëm përcaktohet në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

a) Një person, që ushtron një aktivitet profesional në territorin e një shteti kontraktues, është subjekt i legjislacionit të atij shteti kontraktues, pavarësisht nga shteti ku punëdhënësi ka regjistruar zyrën e vet;

b) Një person, që është anëtar i personelit të udhëtimit apo fluturimit të një kompanie, e cila operon, me qira apo pagesë apo në llogari të vet, shërbime ndërkombëtare transporti për pasagjerë apo mallra dhe ka zyrën e vet të regjistruar në territorin e një shteti kontraktues, është subjekt i legjislacionit të atij shteti kontraktues;

c) Një person, që punon në bordin e një anijeje që mban flamurin e një shteti kontraktues, është subjekt i legjislacionit të shtetit në të cilin ai ka vendqëndrimin.

2. Në rast të ushtrimit të njëkohshëm të një aktiviteti vetëpunësimi në Belgjikë dhe të një aktiviteti pune në Shqipëri, aktiviteti i ushtruar në Shqipëri asimilohet në një aktivitet pune në Belgjikë, në mënyrë që të përcaktohen detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni belg për statusin shoqëror të personave të vetëpunësuar.

3. Personi që ushtron njëkohësisht një aktivitet vetëpunësimi në territorin e të dy shteteve kontraktuese është subjekt vetëm i legjislacionit të shtetit kontraktues në territorin e të cilit ai ka vendqëndrimin e vet të zakonshëm. Për përcaktimin e masës së të ardhurave, në bazë të së cilës përcaktohen kontributet sipas legjislacionit të këtij shteti kontraktues, merren parasysh të ardhurat nga profesioni si person i vetëpunësuar, të fituara në territorin e të dy shteteve, në përputhje me legjislacionin e tyre përkatës.

4. Një person që ushtron njëkohësisht një aktivitet me pagë në territorin e të dy shteteve kontraktuese është subjekt vetëm i legjislacionit të shtetit kontraktues në territorin e të cilit ai ka vendqëndrimin e vet të zakonshëm. Për përcaktimin e masës së të ardhurave, në bazë të së cilës përcaktohen kontributet sipas legjislacionit të këtij shteti kontraktues, merren parasysh të ardhurat nga profesioni si një person i paguar, të fituara në territorin e të dy shteteve, në përputhje me legjislacionin e tyre përkatës.

Neni 8

Dispozita të veçanta

1. Një person i punësuar, i cili duke qenë në shërbim të një punëdhënësi me një zyrë nga e cila ai varet

zakonisht, në territorin e një prej shteteve kontraktuese, dërgohet nga ai punëdhënësi në territorin e shtetit tjetër kontraktues për të punuar për të, mbetet subjekt i legjislacionit të shtetit të mëparshëm kontraktues, sikur të vazhdonte të ishte i punësuar në territorin e tij, me kusht që kohëzgjatja e parashikuar e punës së tij të mos kalojë 24 muaj dhe që ai të mos jetë dërguar për të zëvendësuar një person tjetër, periudha e transferimit të të cilit ka përfunduar. Anëtarët e familjes që shoqërojnë personin e punësuar janë subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues të mëparshëm, nëse nuk ushtrojnë aktivitete profesionale.

2. Nëse transferimi i referuar në paragrafin 1 të këtij neni vazhdon edhe pas 24 muajsh, autoritetet kompetente të të dy shteteve kontraktuese apo agjencitë e caktuara prej tyre mund të bien dakord që punonjësi të mbetet subjekt vetëm i legjislacionit të shtetit të parë kontraktues.

3. Paragrafi 1 i këtij neni zbatohet kur një person që është dërguar nga punëdhënësi i vet nga territori i një shteti kontraktues në territorin e një vendi të tretë, dërgohet më pas nga ai punëdhënësi, nga territori i vendit të tretë në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

4. Punonjësi i një shoqërie transporti që ka zyrën e vet të regjistruar në territorin e një prej shteteve kontraktuese dhe transferohet nga punëdhënësi i vet në territorin e shtetit tjetër kontraktues apo që punon atje përkohësisht apo në mënyrë ambulatorie, është subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues në të cilin shoqëria ka zyrën e vet të regjistruar. Megjithatë, nëse shoqëria ka një degë apo përfaqësim të përhershëm në territorin e shtetit tjetër kontraktues, atëherë punonjësi i punësuar atje është subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues ku është krijuar dega apo përfaqësia e përhershme.

Anëtarët e familjes, që shoqërojnë personin e punësuar, do të jenë subjekt i legjislacionit të të njëjtit Shtet Kontraktues, si dhe personi i punësuar, nëse nuk ushtrojnë aktivitete profesionale.

Neni 9

Nëpunësit e shërbimit civil

Nëpunësit e shërbimit civil dhe personeli ekuivalent i një shteti kontraktues, të transferuar në territorin e shtetit tjetër kontraktues për të ushtruar aktivitetin e tyre atje, si dhe anëtarët e familjes së tyre, që i shoqërojnë dhe nuk ushtrojnë vetë aktivitete profesionale, mbeten subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues të mëparshëm.

Neni 10

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore

1. Shtetasit e një shteti kontraktues, të dërguar nga qeveria e këtij shteti kontraktues në territorin e shtetit

tjetër kontraktues si anëtarë të një misioni diplomatik apo të zyrës konsullore, janë subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues të mëparshëm.

2. Personat e angazhuar në nivel vendor nga një mision diplomatik apo zyrë konsullore e një prej shteteve kontraktuese në territorin e shtetit tjetër kontraktues janë subjekt vetëm i legjislacionit të këtij shteti kontraktues.

3. Kur misioni diplomatik apo zyra konsullore e shtetit akreditues punëson persona, të cilët në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, janë subjekt i legjislacionit të shtetit pritës, misioni apo zyra plotëson detyrimet e përcaktuara për punëdhënësit sipas legjislacionit të këtij shteti.

4. Dispozitat në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, gjithashtu, zbatohen në mënyrë analogjike për personat e punësuar në shërbimin privat të një personi të specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 deri 4 të këtij neni nuk zbatohen për anëtarët e nderit të një zyre konsullore dhe as për personat e punësuar në shërbimin privat të këtyre personave.

6. Dispozitat e këtij neni zbatohen, gjithashtu, për anëtarët e familjeve të personave, të referuar në paragrafët 1 deri 4, që jetojnë në shtëpi, nëse nuk ushtrojnë aktivitet profesional.

Neni 11 Përfitimet

Në interes të personave të caktuar të siguruar apo të kategorive të caktuara të personave të siguruar, autoritetet kompetente, me marrëveshje të ndërsjellë, mund të përcaktojnë përjashtime për dispozitat e neneve 7 deri 10, nëse personat që preken janë subjekt i legjislacionit të një prej shteteve kontraktuese.

PJESA III DISPOZITA TË VEÇANTA PËR PËRFITIMET

KREU 1 SËMUNDJA DHE BARRËLINDJA

Neni 12 Bashkimi i periudhave të sigurimit

Për fitimin, ndërprerjen apo kthimin e së drejtës për përfitime dhe të periudhës gjatë së cilës ato jepen, periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të të dy shteteve bashkohen, kur është e nevojshme dhe në masën që ato nuk mbivendosen.

Neni 13 Përfitimet në natyrë gjatë qëndrimit në territorin e shtetit tjetër kontraktues

1. Një person i siguruar, që ka fituar të drejtën e përfitimit në natyrë sipas legjislacionit të një prej

shteteve kontraktuese dhe gjendja e të cilit kërkon domosdoshmërisht kujdes shëndetësor të menjëhershëm gjatë qëndrimit në territorin e shtetit tjetër kontraktues, fiton të drejtën e përfitimeve në natyrë në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

2. Përfitimet në natyrë jepen në emër të agjencisë kompetente, nga agjencia e vendit të qëndrimit, në përputhje me dispozitat që administron; megjithatë, periudha, gjatë së cilës mund të jepen përfitimet përcaktohet nga shteti kompetent apo agjencia legjislacioni i së cilës zbatohet.

3. Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet:

a) Kur një person i siguruar procedon pa autorizimin e agjencisë kompetente në territorin e shtetit tjetër kontraktues, me qëllim marrjen atje të trajtimit mjekësor;

b) Përveçse në rast të një emergjence absolute, për proteza, pajisje kryesore dhe përfitime të tjera të konsiderueshme në natyrë, lista e të cilave është përcaktuar në marrëveshjen e përbashkët nga autoritetet kompetente.

4. Agjencia kompetente e vendit të qëndrimit duhet të përcaktojë nevojën e menjëhershme për kujdes, të referuar në paragrafin 1 dhe emergjencën absolute të referuar në paragrafin 3.

Neni 14 Përfitimet në natyrë për përfituesit dhe anëtarët e familjes me vendqëndrim në territorin e shtetit tjetër kontraktues

1. Një person i siguruar që ka fituar të drejtën e përfitimeve në natyrë sipas legjislacionit të një prej shteteve kontraktuese dhe që ka vendqëndrimin në territorin e shtetit tjetër kontraktues, si dhe anëtarët e familjes së tij që banojnë aty, gjithashtu, marrin përfitime në natyrë në territorin e këtij shteti tjetër kontraktues.

2. Anëtarët e familjes së një personi të siguruar, subjekt i legjislacionit të një shteti kontraktues dhe që banojnë në territorin e shtetit tjetër kontraktues, marrin përfitime në natyrë në territorin e këtij shteti tjetër kontraktues.

3. Përfitimet në natyrë jepen në emër të agjencisë kompetente nga agjencia e vendit të qëndrimit, në përputhje me dispozitat që administron. Megjithatë, periudha gjatë së cilës mund të jepen përfitimet, përcaktohet nga legjislacioni i shteti kompetent.

4. Paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni nuk zbatohen për anëtarët e familjes, nëse ata kanë një të drejtë të pavarur për përfitime në natyrë, sipas legjislacionit të shtetit kontraktues, në territorin e të cilit ata banojnë.

Megjithatë, një e drejtë e prejardhur për përfitime në natyrë merr përparësi në raport me të drejtat e pavarura, kur e drejta e pavarur në shtetin kontraktues të vendqëndrimit ekziston në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe vetëm mbi bazën e vendqëndrimit të anëtarit në fjalë të familjes në atë shtet kontraktues.

Neni 15

Situata të veçanta në lidhje me përfitimet në natyrë

1. Personi i siguruar që sipas nenit 7, paragrafët 3 dhe 4, si dhe neneve 8 deri 11, është subjekt i legjislacionit të një shteti kontraktues dhe anëtarët e familjes së tij, që e shoqërojnë atë, marrin përfitime në natyrë për të gjithë kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

2. Përfitimet në natyrë jepen në emër të agjencisë kompetente, nga agjencia e vendit të qëndrimit, në përputhje me dispozitat që administron. Megjithatë, periudha gjatë së cilës mund të jepen përfitimet, përcaktohet nga legjislacioni i Shtetit kompetent.

Neni 16

Përfitimet në natyrë për përfituesit e pensioneve të invaliditetit, pleqërisë apo familjar

1. Përfituesi i pensionit të invaliditetit, pleqërisë apo familjar, apo i pagesave në rast aksidenti në punë apo sëmundjeje profesionale, në bazë të legjislacionit të dy shteteve kontraktuese, merr për vete dhe për anëtarët e familjes së tij përfitime në natyrë, në përputhje me legjislacionin e shtetit në territorin e të cilit ai banon dhe në llogari të agjencisë kompetente të këtij shteti.

2. Përfituesi i pensionit të invaliditetit, pleqërisë apo familjar, apo i pagesave në rast aksidenti në punë apo sëmundjeje profesionale, bazuar në mënyrë ekskluzive në legjislacionin e secilit prej shteteve kontraktuese, i cili banon në territorin e shtetit tjetër kontraktues, merr për vete dhe për anëtarët e familjes së tij përfitime në natyrë. Përfitimet në natyrë jepen në emër të agjencisë kompetente, nga agjencia e vendit të qëndrimit, në përputhje me dispozitat që administron. Megjithatë, periudha, gjatë së cilës mund të jepen përfitimet, përcaktohet nga legjislacioni i shtetit kompetent.

Neni 17

Kontributet nga përfituesit e përfitimeve të pleqërisë, familjar dhe invaliditetit

1. Institucioni kompetent i një shteti që është përgjegjës sipas legjislacionit që zbaton për të bërë zbritje të kontributeve për përfitime në natyrë mund të kërkojë dhe kompensojë zbritje të tilla, të llogaritura sipas legjislacionit që zbaton vetëm deri në masën që kostoja e përfitimeve të parashikuara në nenin 16 të kësaj Marrëveshjeje të mbulohet nga një institucion i shtetit në fjalë.

2. Kur në rastet e referuara në nenin 16, paragrafi 2, përfituesi i përfitimeve të pleqërisë, familjar dhe invaliditetit është subjekt i pagesave të kontributeve për të mbuluar përfitimet në natyrë në bazë të legjislacionit të shtetit ku përfituesi në fjalë banon, këto kontribute nuk paguhet për shkak të këtij vendqëndrimi.

Neni 18

Përfitimet në natyrë gjatë një qëndrimi në territorin e shtetit kontraktues kompetent

Personat e referuar në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 14 dhe në paragrafin 2 të nenit 16 të kësaj Marrëveshjeje, të cilët qëndrojnë në territorin e Shtetit Kontraktues kompetent, marrin përfitime në natyrë në territorin e këtij shteti, në llogari të tij dhe në përputhje me dispozitat e administruara nga agjencia e vendit të qëndrimit.

Neni 19

Rimbursimi i përfitimeve në natyrë midis agjencive

1. Masa reale e përfitimeve në natyrë, e dhënë sipas dispozitave të neneve 13, 14, 15 dhe 16 të paragrafit 2 rimbursohet nga agjencia kompetente për agjencinë që ka dhënë këto përfitime, sipas procedurës së parashikuar në Marrëveshjen Administrative.

2. Në marrëveshje të përbashkët, autoritetet kompetente mund të bëjnë plotësisht ose pjesërisht rimbursimin e referuar në paragrafin 1 apo mund të parashikojnë një tjetër mënyrë rimbursimi.

Neni 20

Pagesa e përfitimeve në natyrë

1. Kur një person i siguruar apo anëtarët e familjes së tij fitojnë të drejtën e përfitimeve në natyrë, sipas legjislacionit të një shteti kontraktues, këto përfitime jepen ekskluzivisht nga llogaria e agjencisë kompetente të këtij shteti kontraktues.

2. Kur një person i siguruar fiton të drejtën e përfitimeve në natyrë, sipas legjislacionit të të dy shteteve kontraktuese, zbatohen rregullat si më poshtë:

- a) Këto përfitime jepen nga llogaria e agjencisë së shtetit kontraktues, në territorin e të cilit ato janë dhënë;
- b) Kur përfitimet jepen në territorin e një shteti tjetër, jo në dy shtetet kontraktuese, ato ekskluzivisht paguhet nga llogaria e agjencisë së vendqëndrimit.

Neni 21

Përfitimet në para në rast sëmundjeje dhe barrë lindjeje

1. Personi i siguruar që plotëson kushtet e legjislacionit të shtetit kompetent për të drejtën e përfitimeve në para nga sigurimi për sëmundje dhe barrë lindje, duke marrë në konsideratë, kur është e nevojshme, dispozitat e nenit 12 të kësaj Marrëveshjeje, ruan të drejtën për marrjen e këtyre përfitimeve, nëse ai qëndron në territorin e shtetit tjetër. Përfitimet në para jepen direkt nga agjencia kompetente për përfituesin. Përfitimet në natyrë, të nevojshme për vazhdimin e trajtimit mjekësor të personit të përmendur në këtë paragraf, jepen nga agjencia e vendit të qëndrimit, në

përputhje me legjislacionin që kjo agjenci aplikon në emër të agjencisë kompetente. Megjithatë, periudha gjatë së cilës mund të jepen përfitimet, përcaktohet nga legjislacioni i shtetit kompetent.

2. Përfituesi i përfitimeve në para bazuar në legjislacionin e një shteti kontraktues, ruan ende të drejtën për këto përfitime, nëse transferon vendqëndrimin e tij në territorin e shtetit tjetër kontraktues. Autoriteti kompetent i shtetit debitor të përfitimeve mund të kërkojë një autorizim paraprak nga agjencia kompetente për transferimin e vendqëndrimit. Megjithatë, ky autorizim mund të refuzohet vetëm nëse lëvizja e personit në fjalë nuk këshillohet për shkaqe mjekësore të përcaktuara saktë.

KREU 2 AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE

Neni 22

Përfitimet në natyrë të administruara në territorin e shtetit tjetër kontraktues

1. Personi i siguruar, që për shkak të aksidentit në punë apo të një sëmundjeje profesionale ka të drejtën për përfitim në natyrë, në përputhje me legjislacionin e një shteti kontraktues, merr përfitime në natyrë kur qëndron apo ka vendqëndrimin në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

2. Përfitimet në natyrë jepen në emër të agjencisë kompetente nga agjencia e vendit të qëndrimit apo rezidencës, në përputhje me dispozitat që administrojnë. Megjithatë, periudha gjatë së cilës mund të jepen përfitimet përcaktohet nga legjislacioni i shtetit kompetent.

Neni 23

Rimbursimi i përfitimeve në natyrë midis agjencive

1. Shuma reale e përfitimeve në natyrë, e dhënë në bazë të nenit 22, rimbursohet nga agjencia kompetente tek agjencia që ka dhënë këto përfitime, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Marrëveshjen Administrative.

2. Autoritetet kompetente, me marrëveshje dypalëshe, mund të heqin dorë tërësisht apo pjesërisht rimbursimin e referuar në paragrafin 1 apo të parashikojnë një mënyrë tjetër rimbursimi.

Neni 24

Marrja parasysh e aksidenteve në punë dhe sëmundjeje profesionale që kanë ndodhur më parë

Nëse legjislacioni i një shteti kontraktues parashikon, shprehimisht apo tërthorazi, se aksidentet në punë apo sëmundjet profesionale që kanë ndodhur më parë do të merren në konsideratë për të vlerësuar shkallën e paaftësisë, aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, që kanë ndodhur më parë, sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, do të

konsiderohen sikur të kishin ndodhur sipas legjislacionit të shtetit të parë.

Neni 25

Aksidentet gjatë trafikut të udhëtarëve

Aksidenti që ndodh gjatë trafikut të udhëtarëve në territorin e shtetit kontraktues dhe jo në shtetin kompetent konsiderohet sikur ka ndodhur në territorin e shtetit kontraktues.

Neni 26

Mbikëqyrja e një sëmundjeje profesionale

1. Kur një person i siguruar që vuan një sëmundje profesionale, bazuar në legjislacionin e dy shteteve kontraktuese, ka zhvilluar një aktivitet që nga natyra e tij mund të shkaktojë atë sëmundje, përfitimet që ai apo familjarët e tij mund të kërkojnë do të jepen ekskluzivisht në përputhje me legjislacionin e shtetit në territorin e të cilit është zhvilluar së fundi aktiviteti dhe do t'i nënshtrohet faktit që personi në fjalë të përmbushë kushtet e këtij legjislacioni, duke marrë parasysh, kur është e nevojshme, dispozitat e paragrafit 2.

2. Nëse, bazuar në legjislacionin e shtetit kontraktues, dhënia e përfitimeve për një sëmundje profesionale lidhet me kushtin që sëmundja në fjalë të jetë diagnostikuar fillimisht brenda territorit të tij, ky kusht do të konsiderohet i plotësuar, nëse sëmundja është diagnostikuar fillimisht në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

3. Nëse, bazuar në legjislacionin e një shteti kontraktues, dhënia e përfitimeve për një sëmundje profesionale lidhet me kushtin që aktiviteti që mund të shkaktojë sëmundjen në fjalë të jetë zhvilluar gjatë një periudhe të caktuar, agjencia kompetente e këtij shteti merr parasysh, kur është e nevojshme, periudhat gjatë të cilave ky aktivitet është zhvilluar, bazuar në legjislacionin e shtetit tjetër kontraktues, sikur të ishte zhvilluar sipas legjislacionit të shtetit të parë.

Neni 27

Përkeqësimi i një sëmundjeje profesionale

Në rastin e përkeqësimit të një sëmundjeje profesionale, nëse personi i siguruar që ka marrë apo është duke marrë kompensim për një sëmundje profesionale, sipas legjislacionit të çdonjërit prej shteteve kontraktuese, për një sëmundje profesionale të së njëjtës natyrë, kërkon të drejtat për përfitime sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) Nëse personi në fjalë nuk ka zhvilluar në territorin e shtetit të fundit një aktivitet profesional që mund të shkaktojë apo përkeqësojë sëmundjen në fjalë, agjencia kompetente e shtetit të mëparshëm do të jetë përgjegjëse për mbulimin e kostos së përfitimeve sipas dispozitave të legjislacionit që administrojnë, duke marrë parasysh përkeqësimin;

b) Nëse personi në fjalë ka realizuar një aktivitet të tillë profesional në territorin e shtetit tjetër, agjencia kompetente e shtetit të mëparshëm do të jetë përgjegjëse për mbulimin e kostove të përfitimeve sipas dispozitave të legjislacionit që administrojnë, pa marrë parasysh përkeqësimin; agjencia kompetente e shtetit të dytë do të japë një shtesë për personin në fjalë, shuma e së cilës do të përcaktohet nga legjislacioni i këtij shteti dhe do të jetë e barabartë me diferencën midis shumës totale të përfitimit pas përkeqësimit dhe shumës së përfitimit që duhej paguar para se të ndodhte përkeqësimi.

KREU 3
PËRFITIMET E PLEQËRISË, FAMILJARE DHE
INVALIDITETIT

Neni 28

Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, për marrjen, mbajtjen apo rimarrjen e së drejtës për përfitim pleqërie, familjar apo invaliditeti, periudhat e sigurimit dhe periudhat ekuivalente të plotësuara sipas legjislacionit të njërit nga shtetet kontraktuese për përfitimet e pleqërisë, familjare ose invaliditeti, do të bashkohen, kur është e nevojshme dhe deri në shkallën që ato të mos mbivendosen, me periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues.

Kur periudhat e njohura si periudha ekuivalente me një periudhë sigurimi përputhen, Belgjika do të marrë parasysh vetëm periudhat ekuivalente që vijnë direkt pas një aktiviteti profesional në Belgjikë.

2. Nëse legjislacioni i njërit prej shteteve kontraktuese e lidh dhënien e përfitimit të pleqërisë, familjar ose invaliditetit, me kushtin që periudhat e sigurimit të plotësohen në një profesion të caktuar, do të bashkohen për dhënien e së drejtës të këtyre përfitimeve vetëm periudhat e sigurimit të plotësuara apo të njohura si ekuivalente në të njëjtin profesion në shtetin tjetër kontraktues.

3. Nëse legjislacioni i njërit prej shteteve kontraktuese e lidh dhënien e përfitimit të pleqërisë, familjar ose invaliditetit, me kushtin që periudhat e sigurimit të plotësohen në një profesion të caktuar dhe kur këto periudha nuk çojnë në të drejtën për përfitimet në fjalë, periudhat në fjalë do të konsiderohen të vlefshme për caktimin e përfitimeve të pleqërisë, familjar apo invaliditetit, të dhëna në skemën e përgjithshme të personave të punësuar.

4. Nëse, pavarësisht zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni, një person nuk përmbush kriteret për të marrë një përfitim, do të bashkohen periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të një shteti të tretë me të cilin të dy Shtetet Kontraktuese kanë marrëveshje për sigurimet shoqërore, që mundësojnë bashkimin e periudhave të sigurimit.

5. Nëse vetëm Belgjika është e lidhur me një vend të tretë me anë të një marrëveshjeje për sigurimet shoqërore, që zbatohet për personin në fjalë, periudhat e sigurimit të plotësuara në përputhje me legjislacionin e këtij shteti të tretë do të bashkohen për përfitimin e së drejtës për përfitim pleqërie, familjar dhe invaliditeti në të dy shtetet kontraktuese.

Neni 29

Llogaritja e përfitimit të pleqërisë dhe pensionit familjar

1. Nëse një person fiton të drejtën për përfitim pleqërie apo familjar, sipas legjislacionit të njërit prej shteteve kontraktuese pa pasur nevojën për bashkimin e periudhave të sigurimit, agjencia e këtij shteti do ta llogarisë përfitimin bazuar direkt te periudhat e sigurimit të përmbushura në këtë shtet dhe vetëm sipas legjislacionit të tij.

Kjo agjenci do të llogarisë edhe masën e përfitimit të pleqërisë apo familjar, që do të mund të merrej duke zbatuar rregullat e specifikuar në paragrafin 2(a) dhe (b). Do të merret parasysh vetëm masa më e madhe ndër këto dy masa.

2. Nëse një person fiton të drejtën për përfitim pleqërie apo familjar nga legjislacioni i një prej shteteve kontraktuese, kur kjo e drejtë fitohet vetëm me bashkimin e periudhave të sigurimit sipas nenit 28, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

a) Agjencia e këtij shteti kontraktues do të llogarisë shumën teorike të përfitimit sikur të gjitha periudhat e sigurimit të përmbushura sipas legjislacioneve të dy shteteve kontraktuese të ishin plotësuar sipas legjislacionit të vet;

b) Agjencia e këtij shteti kontraktues më pas do të llogarisë shumën për t'u paguar, bazuar në masën e specifikuar sipas "a", në raport me kohëzgjatjen e periudhave të sigurimit sipas legjislacionit të vet, të lidhur me kohëzgjatjen e të gjitha periudhave të sigurimit të llogaritura sipas "a".

3. Nëse kohëzgjatja e periudhave të sigurimit të bashkuara, sipas nenit 28 të kësaj Marrëveshjeje, e kalon maksimumin e periudhës së sigurimit të mundshme, sipas legjislacionit të zbatuar, agjencia kompetente përcakton masën e përfitimit proporcional ndaj periudhave të sigurimit, të përmbushura sipas këtij legjislacioni në raport me periudhat e sigurimit që kanë shërbyer si bazë për llogaritjen e masës së përfitimit të pandarë.

Neni 30

Llogaritja e përfitimeve të invaliditetit

1. Nëse e drejta për përfitime invaliditeti e parashikuar nga legjislacioni i njërit prej shteteve kontraktuese lind vetëm pas bashkimit të periudhave të

sigurimit, të përmbushura në të dy shtetet kontraktuese në përputhje me nenin 28 të kësaj Marrëveshjeje, masa e përfitimit për t'u paguar përcaktohet sipas procedurës së specifikuar në nenin 29, paragrafi 2 i kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse e drejta për përfitime invaliditeti në Belgjikë është hapur pa u bazuar te dispozitat e nenit 28 të kësaj Marrëveshjeje, dhe nëse masa që rezulton nga shuma e përfitimit shqiptar të invaliditetit dhe përfitimit belg të invaliditetit, llogaritur në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, është më e ulët se masa e përfitimit për t'u paguar, bazuar vetëm në legjislacionin belg, agjencia kompetente belge do të japë një shtesë të barabartë me diferencën e totalit të këtyre dy përfitimeve dhe shumës për t'u dhënë vetëm sipas legjislacionit belg.

Neni 31

Përfitimet e invaliditetit gjatë një qëndrimi në shtetin tjetër kontraktues

Përfituesi i një përfitimi për invaliditet sipas legjislacionit të njërit prej shteteve kontraktuese ka ende të drejtë për këtë përfitim gjatë një qëndrimi të tij në shtetin tjetër kontraktues, kur ky qëndrim është autorizuar fillimisht nga agjencia kompetente e shtetit të parë kontraktues. Megjithatë, ky autorizim mund të refuzohet vetëm nëse qëndrimi ndodh në periudhën gjatë së cilës sipas legjislacionit të shtetit të parë kontraktues, agjencia kompetente e këtij shteti kontraktues duhet të vlerësojë apo rishikojë gjendjen e invaliditetit.

Neni 32

Periudhat e sigurimit më të shkurtra se një vit

Pavarësisht nga dispozitat e nenit 28, në rastet e synuara në nenin 29, paragrafi 2 dhe nenin 30, paragrafi 1, nuk jepet asnjë përfitim invaliditeti, pleqërie apo familjar nga agjencia kompetente belge kur periudhat e sigurimit të plotësuar, sipas legjislacionit të vet, që i paraprijnë riskut, nuk arrijnë në total një vit.

Neni 33

Rishikimi i mundshëm i përfitimeve

1. Nëse, për shkak të rritjes së kostos së jetesës, lëvizjes së niveleve të pagave apo kushteve të tjera të përshtatjes, përfitimet e pleqërisë, familjare ose invaliditetit të njërit prej shteteve kontraktuese, ndryshojnë me një përqindje apo shumë të caktuar, nuk është e nevojshme të procedohet me një llogaritje të re të përfitimeve të pleqërisë, familjare apo invaliditetit të shtetit tjetër kontraktues.

2. Nga ana tjetër, në rast të modifikimit të rregullave të procesit të llogaritjes në lidhje me dhënien e përfitimeve të pleqërisë, familjare apo invaliditetit, do të bëhet një llogaritje e re sipas neneve 29 dhe 30. Kjo

dispozitë nuk do të ndikojë mbi përfitimet e paguara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij rishikimi.

PJESA IV DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 34

Përgjegjësitë e autoriteteve kompetente

Autoritetet kompetente:

a) Me anë të masave administrative, marrin masat e kërkuara për të zbatuar këtë Marrëveshje dhe caktojnë agjencitë koordinuese, agjencitë e vendit të qëndrimit apo rezidencës dhe agjencitë kompetente;

b) Përcaktojnë procedurat për asistencën e përbashkët administrative, duke përfshirë pjesëmarrjen në shpenzimet lidhur me marrjen e evidencave mjekësore, administrative apo të tjera që nevojiten për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

c) Komunikojnë direkt me njëra-tjetrën çdo informacion lidhur me masat e marra për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

d) Komunikojnë direkt me njëra-tjetrën, sa më shpejt të jetë e mundur, të gjitha ndryshimet në legjislacionin e tyre në masën që këto ndryshime ndikojnë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 35

Bashkëpunimi administrativ

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente, si dhe agjencitë kompetente të të dy shteteve kontraktuese shkëmbejnë praktikata e duhura, siç mund të vepronin për zbatimin e legjislacionit të tyre. Në parim, kjo asistencë bëhet pa pagesë; megjithatë, autoritetet kompetente mund të bien dakord për rimbursimin e disa shpenzimeve.

2. Përfitimi nga përjashtimet apo ulja e taksave, pagesa e vulave apo tarifave e regjistrimit, apo dokumentimit që janë parashikuar në legjislacionin e njërit shtet kontraktues lidhur me certifikatat apo dokumentet e tjera, meqë do të duhet të përgatiten për zbatimin e legjislacionit të atij shteti do të shtrihen te certifikatat dhe dokumentet e tjera të ngjashme që do të përgatiten për zbatimin e legjislacionit të shtetit tjetër.

3. Të gjitha aktet dhe dokumentet që do të duhet të përgatiten për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të përjashtohen nga noterizimi nga ana e autoriteteve diplomatike apo konsullore.

4. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente dhe agjencitë e shteteve kontraktuese mund të komunikojnë direkt me njëri-tjetrin, si dhe me çdo person, pavarësisht vendqëndrimit të personit. Ky komunikim mund të bëhet në një nga gjuhët e përdorura për qëllimet zyrtare të shteteve kontraktuese.

Neni 36

Kërkesat, njoftimet dhe apelimet

Kërkesat, njoftimet apo apelimet që sipas legjislacionit të njërit prej shteteve kontraktuese duhet të dorëzohen brenda një periudhe të caktuar te një autoritet, agjenci apo juridiksion i atij shteti kontraktues, do të pranohen nëse paraqiten brenda së njëjtës periudhë të specifikuar te një autoritet, agjenci apo juridiksion i shtetit tjetër kontraktues. Në këtë rast, kërkesat, njoftimet apo apelimet duhet të dërgohen pa vonesa tek autoriteti apo agjencia e shtetit kontraktues të parë direkt ose përmes autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese.

Datat në të cilat këto kërkesa, njoftime apo apelime dorëzohen te një autoritet, agjenci apo juridiksion i shtetit të dytë kontraktues konsiderohen si data të dorëzimit tek autoriteti, agjencia apo juridiksioni i autorizuar për të pranuar këto kërkesa, njoftime apo apelime.

Një aplikim apo dokument nuk mund të refuzohet nga autoriteti kompetent apo organizatat e një shteti kontraktues vetëm për shkak se është në gjuhën zyrtare të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 37

Shkëmbimi i të dhënave personale

1. Agjencitë e të dy shteteve kontraktuese autorizohen për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe për shkëmbimin e të dhënave personale, përfshirë të dhëna në lidhje me të ardhurat e personave që mund t'i nevojiten agjencisë së shtetit kontraktues për zbatimin e legjislacionit të sigurimeve shoqërore.

2. Gjatë komunikimit të këtyre të dhënave, agjencia e një shteti kontraktues duhet të respektojë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të këtij shteti kontraktues.

3. Mbajtja, përpunimi dhe shpërndarja e të dhënave personale nga agjencia e shtetit kontraktues, të cilit i janë komunikuar këto të dhëna, rregullohet nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale të këtij shteti kontraktues.

4. Të dhënat, të cilat janë referuar në këtë nen, do të përdoren ekskluzivisht për zbatimin e legjislacionit për sigurimet shoqërore.

Neni 38

Pagesat e përfitimeve

Pagesa e përfitimeve, bazuar në këtë Marrëveshje, mund të bëhet në monedhën e secilit shtet kontraktues.

Nëse personi i interesuar vendos të marrë përfitimin e paguar në monedhë tjetër dhe jo në monedhën zyrtare të një prej shteteve kontraktuese, risku i shkëmbimit mbulohet nga personi i interesuar.

Transfertat për shkak të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje kryhen sipas rregullimeve në fuqi të vendosura ndërmjet shteteve kontraktuese.

Dispozitat ligjore, lidhur me kontrollin e monedhës së një shteti kontraktues, nuk mund të ndërhyjnë në transferimin e fondeve që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 39

Njohja e vendimeve dhe dokumenteve që aplikohen

1. Të gjitha vendimet në fuqi të gjykatave, si dhe vendimet e zbatueshme të agjencisë kompetente apo autoriteteve kompetente të një shteti kontraktues në lidhje me kontributet dhe përfitimet nga sigurimet shoqërore, do të njihen nga shteti tjetër kontraktues.

2. Njohja mund të refuzohet vetëm në rast kur bie ndesh me rendin publik të shtetit kontraktues në të cilin do të zbatohet dokumenti apo vendimi në fjalë.

3. Procedura e zbatimit të vendimeve dhe akteve të formës së prerë duhet të jetë në përputhje me legjislacionin e shtetit kontraktues në territorin e të cilit do të bëhet zbatimi, që mbikëqyr zbatimin e këtyre vendimeve dhe akteve. Vendimi apo akti duhet të shoqërohet nga një vërtetim që konfirmon zbatueshmërinë e tij.

4. Kontributet e paguara dhe përfitimet e tyre do të kenë, brenda qëllimit të procedurës së zbatimit, falimentimit apo marrëveshjes së detyruar në territorin e shtetit tjetër kontraktues, të njëjtën shkallë preference si kërkesat përkatëse në territorin e këtij shteti kontraktues.

5. Kërkesat, që janë subjekt i korrigjimit apo korrigjimit të detyruar, mbrohen nga të njëjtat garanci dhe privilegje si kërkesat e së njëjtës natyrë të një agjencie që ndodhet në territorin e shtetit kontraktues në të cilin është bërë korrigjimi apo korrigjimi i detyruar.

Neni 40

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që lindin nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen, në masën e mundshme, nga autoritetet kompetente.

Neni 41

Pagesat e papaguara

1. Kur agjencia e një shteti kontraktues i ka paguar përfituesit të përfitimit një shumë që kalon atë për të cilën i ka lindur e drejta, kjo agjenci mund të kërkojë, sipas kushteve dhe brenda kufijve të legjislacionit që zbaton, që agjencia e shtetit tjetër, e cila duhet të paguajë përfitimin në fjalë për përfituesin në fjalë, të zbrësë shumën e tepërt nga pagesat e tejkaluara të përfituesit në fjalë. Agjencia e dytë bën zbritjen sipas kushteve dhe brenda kufijve në të cilët është autorizuar ky kompensim në lidhje me legjislacionin që zbaton, sikur të ishte shuma e paguar tepër nga ana e tij dhe transferon shumën e hequr tek agjencia kredituese.

2. Nëse shuma e tepërt nuk mund të zbritet nga borxhet e papaguara, agjencia e një shteti kontraktues, që i ka paguar përfituesit një shumë përfitimi që tejkalon atë që i është dhënë e drejta, sipas kushteve dhe kufijve të specifikuar nga legjislacioni që zbaton, mund të kërkojë që agjencia që paguan përfitimin të shteti tjetër kontraktues në favor të këtij përfituesi, të zbresë shumën e tepërt nga shuma që i paguan përfituesit. Agjencia e dytë bën zbritjen sipas kushteve dhe brenda kufijve që janë përcaktuar për këtë përfitim nga legjislacioni që zbaton, sikur të ishin shuma të paguara tepër nga ana e saj dhe transferon shumën e zbritur tek agjencia kredituese.

Neni 42

Bashkëpunimi në luftën kundër mashtrimit

Gjatë zbatimit të parimeve të përgjithshme në lidhje me bashkëpunimin administrativ, autoritetet kompetente bien dakord për një marrëveshje administrative për rregullat në lidhje me të cilat ata do të bashkëpunojnë në luftën kundër mashtrimit lidhur me kontributet dhe përfitimet e sigurimeve shoqërore që kalojnë kufijtë e shtetit kontraktues, dhe veçanërisht në lidhje me vendqëndrimin aktual të personave, vlerësimin e të ardhurave, llogaritjen e kontributeve dhe mbledhjen e përfitimeve.

PJESA V

DISPOZITA TË PËRKOHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 43

Ngjarje të ndodhura para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje

1. Kjo Marrëveshje zbatohet edhe për ngjarjet e ndodhura para hyrjes së saj në fuqi.

2. Kjo Marrëveshje nuk do të krijojë të drejta për të kërkuar përfitim për çdo periudhë para hyrjes së saj në fuqi.

3. Të gjitha periudhat e sigurimit të përmbushura sipas legjislacionit të njërit shtet kontraktues para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, merren në konsideratë në përcaktimin e së drejtës për përfitim, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

4. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për të drejtat që janë likuiduar nga dhënia e një pagese shume totale apo rimbursimi i kontributeve.

Neni 44

Rishikimi, parashkrimi dhe dënimi

1. Çdo përfitim që nuk i është paguar apo që është pezulluar për arsye të kombësisë së personit në fjalë apo për arsye të vendqëndrimit të tij në territorin e një shteti kontraktues, përveç atij në të cilin ndodhet agjencia përgjegjëse për pagesë, me kërkesën e personit të interesuar do të paguhet apo rivendoset që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

2. E drejta e personave të interesuar, të cilët para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje kanë marrë pagesën e një përfitimi, mund të rishikohet gjatë aplikimit nga ata persona, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Në asnjë rast ky rishikim nuk do të çojë në zbritjen e së drejtës së parë të personit në fjalë.

3. Nëse kërkesa e referuar në paragrafët 1 ose 2 të këtij neni bëhet brenda dy viteve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo e drejtë që rrjedh nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë efektive nga ajo datë dhe legjislacioni i secilit shtet kontraktues në lidhje me humbjen apo parashkrimin e të drejtave nuk do të jetë i zbatueshëm për personin në fjalë.

4. Nëse kërkesa e referuar në paragrafin 1 ose 2 të këtij neni bëhet pas dy vjetësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të drejtat që nuk janë subjekt i humbjes apo që nuk janë parashkruar, do të merren nga data e kërkesës, në rast se nuk do të ketë dispozita legjislative më të favorshme të shtetit kontraktues në fjalë.

Neni 45

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje do të përmbushet pa kufizim në kohëzgjatjen e saj. Ajo mund të anulohet nga secili shtet kontraktues duke dhënë një njoftim me shkrim 12 muaj përpara.

Neni 46

Garantimi i të drejtave që fitohen gjatë kohës së marrjes së përfitimit

Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha të drejtat dhe pagesat e përfitimeve të marra sipas kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë. Shtetet kontraktuese do të bëjnë marrëveshje në lidhje me të drejtat gjatë vazhdimet të marrjes së përfitimit.

Neni 47

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas datës së marrjes së njoftimit me anë të të cilit pala e fundit e të dyja shteteve kontraktuese ka njoftuar shtetin tjetër kontraktues se të gjitha kërkesat e brendshme janë përmbushur.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Bruksel, më 9.12.2013, në dy kopje, në gjuhët angleze, shqipe, frënge dhe holandeze, ku secili tekst është njëloj autentik. Në rast të ndonjë divergjence në interpretim, do të mbizotërojë teksti në anglisht.

PËR MBRETËRINË E
BELGJIKËS

Znj. Laurette Onkelinx

Zv.kryeministre,
Ministër i Çështjeve Sociale e
Shëndetit Publik

PËR REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË

Z. Erion Veliaj

Ministër i Mirëqënies Sociale
dhe Rinisë

LIGJ
Nr. 41/2014

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8668, DATË
23.11.2000, “PËR PAJISJEN E SHTETASVE
SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË
SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 8668, datë 23.11.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, pas nenit 14/1 shtohet neni 14/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 14/2

Dispozitë kalimtare

Afati i vlefshmërisë së pasaportave biometrike, të lëshuara gjatë periudhës 1 prill 2009 – 31 korrik 2010, me afat vlefshmërie 10 vjet, për të gjithë shtetasit shqiptarë me moshë deri në 16 vjeç në kohën e aplikimit, zgjatet me 1 vit nga dita e plotësimit të afatit ligjor prej 5 vitesh.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 17.4.2014

DEKRET
Nr. 8546, datë 21.4.2014

PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E
PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË
TË LIGJIT

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe 4 dhe nenit 93 të Kushtetutës së Shqipërisë, bazuar në kërkesën e Kuvendit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 41/2014 “Për një shtesë në ligjin nr. 8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shteti”, të ndryshuar”.

Neni 2

Dhënie e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 41/2014 “Për një shtesë në ligjin nr. 8668, datë

23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 19/2014

PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.
8053, DATË 21.12.1995, “PËR KALIMIN NË
PRONËSI, PA SHPËRBLIM, TË TOKËS
BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, të ndryshuar”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 10.4.2014

VENDIM
Nr. 20/2014

PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ERMIR KAPEDANI
KOMISIONER NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT
TË POPULLIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Avokatit të Popullit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Ermir Kapedani zgjidhet komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 10.4.2014

**VENDIM
Nr. 21/2014**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ARBEN SHKËMBI
KOMISIONER NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT
TË POPULLIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Avokatit të Popullit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

- I. Zoti Arben Shkëmbi zgjidhet komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 10.4.2014

**VENDIM
Nr. 22/2014**

**PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS ETILDA GJONAJ
(SALIU) KOMISIONERE NË INSTITUCIONIN E
AVOKATIT TË POPULLIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Avokatit të Popullit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

- I. Zonja Etilda Gjonaj (Saliu) zgjidhet komisionere në Institucionin e Avokatit të Popullit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 10.4.2014

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 24 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006